



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 qershor 2016
Nr. ref.:RK956/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI154/14

Parashtrues

Bujar Nrecaj dhe Haxhi Nrecaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 4079/2013, të 24 marsit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Bujar Nrecaj dhe z. Haxhi Nrecaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesit), nga fshati Lutoglavë, komuna e Prizrenit.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 4079/2013, i 24 marsit 2014, të cilin parashtruesit pohojnë se e kanë pranuar më 26 maj 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesit pretendojnë se u është shkelur e drejta e pronës, sipas nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Bazë e parashtrimit të kërkesës është neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 tetor 2014, parashtruesit dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar.
6. Më 6 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI154/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI154/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 18 nëntor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës së tyre me numër KI154/14.
8. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e zëvendësoi gjyqtaren raportuese Arta Rama-Hajrizi me gjyqtarin Robert Carolan. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës e zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu, mandati i të cilit përfundoi në Gjykatën Kushtetuese, me gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi, si anëtare e Kolegjit shqyrtues.
9. Më 9 shtator 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 20 maj 2011, parashtruesit janë paditur në Gjykatën Komunale në Prizren, për pengimposedimin e lirë dhe për fund faktik të servitutit të kalimit të rrugës.
11. Gjykata Komunale në Prizren, me Aktvendimin C. nr. 293/11, të 20 dhjetorit 2012, ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve kundër të paditurve/parashtruesve, për pengimposedimin e lirë dhe për fundin faktik të servitutit të kalimit të rrugës. Gjatë procedimit të kësaj çështjeje juridike, pala paditëse nuk i ofroi Gjykatës provën materiale e cila do të vërtetonte faktin se si është krijuar ky servitut kalimi (titulli juridik), si dhe nëse është konstituar i njëjti dhe nëse është regjistruar në regjistrin për themelimin e të drejtave të pronës së paluajtshme. Si rrjedhojë, kjo gjykatë, *inter alia*, arsyeton:

“Gjykata erdhi në përfundim se LPDS-ja [Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore] ofron mbrojtje vetëm për të drejtat e servituteve të cilat janë regjistruar në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri (neni 259), [konform Ligjit për Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Pluajtshme i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/22, së bashku me ndryshimet e mëvonëshme që i janë bërë këtij ligji] ndërsa nuk ofron mbrojtje gjyqësore për ato servitute të cilat nuk janë regjistruar në këtë regjistër. Nga provat që janë administruar në shqyrtimin kryesor gjykatës i rezultoi se paditësit nuk e kanë të fituar të drejtën e servitutit të kalimit nëpër pronën e të paditurve [parashtruesve], si dhe nuk e kanë të regjistruar këtë të drejtë në regjistrin e të drejtave për paluajtshmëri, andaj edhe të njëjtit nuk kanë të drejtë në mbrojtjen e posedimit të së drejtës së servitutit të kalimit, kështuqë kërkesëpadia e tyre u desh të refuzohet si e pabazuar”.

12. Për më tepër, lidhur me pretendimin e palës paditëse se në rastin konkret duhet të zbatohet neni 480 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata (Gjykata Komunale në Prizren) vlerësoi se *“ky nen zbatohet në të gjitha rastet kur cenohet ose pengohet posedimi i sendeve, por jo edhe kur cenohen të drejtat, sikurse në rastin konkret e drejta e servitutit të kalimit”.*
13. Kundër këtij aktvendimi, paditësit kanë parashtruar ankesë me të cilën kanë kërkuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës që ta ndryshojë aktvendimin e ankimuar dhe të aprovojë kërkesëpadinë e paditësve ose të prishë aktvendimin e ankimuar dhe lëndën ta kthejë në rigjykim te gjyqtari tjetër.
14. Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin CA. nr. 783/2013, të 3 korrikut 2013, ka prishur Aktvendimin e Gjykatës Komunale të Prizrenit, C. nr. 293/11, të 20 dhjetorit 2012, dhe lëndën ia ka kthyer Gjykatës Themelore të

Prizrenit për rishqyrtim dhe për rivendosje me arsyetimin se “[...] gjykata e shkallës së parë me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësve si të pabazuar, gabimisht ka zbatuar dispozitën e nenit 259 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, meqë kjo dispozitë nuk ofron mbrojtje gjyqësore për ato servitute të cilat nuk janë të regjistruara në regjistrin për të drejtat në paluajtshmëri”.

15. Gjithashtu, Gjkata e Apelit nuk e aprovoi si të rregullt dhe të ligjshëm konstatimin e gjykatës së shkallës së parë, se “dispozita e nenit 480 të LPK-së zbatohet në të gjitha rastet kur cenohet ose pengohet posedimi i sendeve, por jo edhe kur cenohet e drejta sikur në rastin konkret e drejta e servitutit të kalimit”. Sepse, sipas vlerësimit të kësaj gjykate: “Duke marrë parasysh dispozitën e nenit 480 të LPK-së, [...] në rastet kur shqyrtohet padia lidhur me pengimin e posedimit, gjykata duhet të kufizohet vetëm me provimin e gjendjes së fundit të posedimit dhe ndodhjen e pengimit si dhe të vërtetojë kohën e kryerjes së aktit të pengim posedimit [...]”.
16. Më 30 tetor 2013, Gjkata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin C. nr. 614/13, ka pranuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar, duke vërtetuar se të paditurit/parashtruesit kanë bërë pengimin e posedimit të shfrytëzimit të lirë dhe të fundit faktik të servitutit të kalimit të rrugës që dërgon paditësit në pronat e tyre. Ndër të tjera, ky aktvendim arsyeton:

“Duke respektuar qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit të dhënë në këtë çështje juridike-kontestimore, përmes Aktvendimit CA. nr. 783/13, të 3 korrikut 2013, ku ndër të tjera është theksuar se edhe servitutet e paregjistruara gëzojnë mbrojtje juridike (nëse merret posedimi apo krijohen pengesa në shfrytëzimin e tyre në mënyrë të kundërligjshme), atëherë konform nenit 480 të LPK-së, gjykata është kufizuar vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit, pa u lëshuar në shqyrtimin lidhur me të drejtën e posedimit, bazën juridike të posedimit, ndërgjegjshmërinë apo pandërgjegjshmërinë e posedimit. [...] Nga provat e administruara, gjykatës i rezultoi se paditësit kanë qenë posedues të fundit faktik të rrugës kontestuese [...], ndërsa të paditurit [parashtruesit] i kanë privuar nga posedimi poseduesit kundër vullnetit të tyre [...], me këtë rast kanë vepruar kundërligjshëm, ku si rezultat i kësaj gjykata vendosi që t’i jap mbrojtje gjyqësore paditësve”.

17. Me ankesën C. nr. 614/13, të 25 nëntorit 2013, parashtruesit kanë kërkuar nga Gjkata e Apelit e Kosovës që ta ndryshojë Aktvendimin C. nr. 614/13, të 30 tetorit 2013, të Gjykatës Themelore në Prizren dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë si të pabazuar, për shkak të zbatimit të gabuar të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore.

18. Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin CA. nr. 4079/2013, të 24 marsit 2014, e ka refuzuar ankesën e të paditurve/parashtruesve si të pabazuar dhe e ka vërtetuar Aktvendimin C. nr. 614/13, të 30 tetorit 2013, të Gjykatës Themelore në Prizren, me këtë arsyetim:

“Megjenëse objekti i kontestit është pengim posedimi, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin dhe argumentimin e fakteve të gjendjes faktike të posedimit dhe pengimit të shtuar. Në këtë kontest është përjashtuar ekzaminimi i së drejtës së posedimit, lidhur me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë apo pandërgjegjshmërinë e posedimit. Në rastin konkret nuk ka rëndësi se paditësit a kanë të drejtën e servitutit të kalimit në rrugën kontestuese. [...] Se paditësit faktikisht e kanë shfrytëzuar rrugën kontestuese është fakt i pakontestueshëm, që nuk kontestohet as me ankesë. Ankesa e konteston bazën juridike të servitutit të kalimit, duke theksuar se e drejta nuk është vendosur me akt juridik dhe regjistrimin në regjistër të së drejtës së patundshmërisë”.

19. Më 30 maj 2014, të paditurit/parashtruesit kanë kërkuar nga Kryeprokurori i Shtetit që të ngrejë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktvendimit C. nr. 614/13, të 30 tetorit 2013, të Gjykatës Themelore në Prizren dhe Aktvendimit CA. nr. 4079/2013, të 24 marsit 2014, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore.
20. Më 10 korrik 2014, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, nëpërmjet Njoftimit KMLC. nr. 58/14, njoftoi të paditurit/parashtruesit se pas shqyrtimit të propozimit për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk ka gjetur bazë ligjore për ngritjen e këtij mjeti.
21. Me një kërkesë të përsëritur të 22 gushtit 2014, të paditurit/parashtruesit kanë kërkuar prapë nga Kryeprokurori i Shtetit ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktvendimeve të lartcekura dhe për shkaqet e lartcekura.
22. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, me Njoftimin KMLC. nr. 58/14, të 26 gushtit 2014, i njoftoi të paditurit/parashtruesit se qëndron pranë Njoftimit KMLC. nr. 58/14, të 10 korrikut 2014, se nuk ka gjetur bazë ligjore për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesit pretendojnë se Aktvendimi C. nr. 614/13, i 30 tetorit 2013, i Gjykatës Themelore në Prizren dhe Aktvendimi CA. nr. 4079/2013, i 24 marsit 2014, i Gjykatës së Apelit të Kosovës shkelin të drejtat e tyre individuale. Rrjedhimisht, pretendojnë se me këto vendime u është

shkeluar e drejta e pronës, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

24. Për më tepër, parashtruesit kërkojnë: *“A është cenuar paraqitësve të kërkesës e drejta e disponimit të lirë dhe të papenguar e pronës e drejtë e cila është e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si rezultat i vendim-marrjes nga Gjykata e Apelit të Kosovës?”*.
25. Më konkretisht, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese si në vijim:
- I. *“Kërkesën e Paraqitësve të Kërkesës ta konstatojë të Pranueshme;*
 - II. *Në përputhje me Rregullin 39 të Rregullorës së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore;*
 - III. *Të konstatojë se Aktvendimi C. nr. 614/13 i Gjykatës Themelore në Prizren dhe Aktvendimi CA. nr. 4079/2013 i Gjykatës së Apelit të Kosovës paraqet shkelje të të drejtave individuale të Paraqitësve të Kërkesës. Këto shkeje kanë të bëjnë me të drejtën e pronës të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;*
 - IV. *Të përcaktojë çfarëdo të drejte ose përgjegjësie për palët në këtë Kërkesë që kjo Gjykatë e nderuar i vlerëson si të arësyeshme dhe të bazuara juridikisht”*.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:
- “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*.
28. Përveç kësaj, neni 47.2 i Ligjit, përcakton:
- “Individi mund ta ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*.
29. Gjithashtu, Gjykata në këtë rast, i referohet edhe rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

b) Janë shteruar të gjitha mjetet efektive juridike të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar, [...].”

30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesit e kanë parashtruar ankesën kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore të Prizrenit, si mjet efektiv. Kurse, kundër aktvendimit të cilin Gjykata e Apelit e ka nxjerrë lidhur me ankesën e tyre nuk është i lejuar revizioni. Për më tepër, dispozita e nenit 481, paragrafi 4, e Ligjit për Procedurën Kontestimore parasheh:

“Kundër aktvendimeve të dhëna në kontestet për shkak të pengim posedimit revizioni nuk është i lejuar”.

31. Gjithashtu, Gjykata vëren se parashtruesit dy herë kanë kërkuar nga Prokurori i Shtetit që të ngrejë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit, por kanë marrë përgjigje negative, me arsyetimin se Prokurori i Shtetit nuk ka gjetur bazë ligjore për të ngritur kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.
32. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesit janë palë e autorizuar dhe i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të aplikueshëm.
33. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

34. Gjithashtu, Gjykata merr në konsideratë rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi, [...].”

35. Për të qenë në gjendje të verifikojë nëse kërkesa është parashtruar brenda afatit ligjor, Gjykata merr në konsideratë “vendimin e fundit” me të cilin

- është vendosur lidhur me kërkesën e parashtruesve, datën në të cilën parashtruesit e kanë pranuar këtë vendim dhe datën e dorëzimit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese (Shih Aktvendimin për papranueshmëri KI201/13, të 2 prillit 2014, *Sofa Gjonbalaj kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme*, Rev. nr. 299/2011, i 17 prillit 2013).
36. Sa i përket “vendimit të fundit”, Gjykata konsideron se Aktvendimi CA. nr. 4079/2014 i Gjykatës së Apelit të Kosovës, i 20 marsit 2014, është vendimi i fundit lidhur me kërkesën e parashtruesve. Njëherit, ky është vendimi, kushtetutshmërinë e të cilit e kontestojnë parashtruesit.
 37. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se aktvendimi i lartcekur është nxjerrë më 24 mars 2014, kurse parashtruesit këtë aktvendim e kanë pranuar më 26 maj 2014. Në këtë kontekst, si *dies a quo* e afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, merret data e pranimit të aktvendimit nga parashtruesit, gjegjësisht 26 maji 2015. Afati fillon të llogaritet nga vendimi i plotfuqishëm, si rezultat i shterjes së mjeteve adekuate dhe efektive për të siguruar korrigjimin e çështjes që është objekt i ankesës (Shih, *mutatis mutandis*, *Norkin kundër Ruisë*, Kërkesa 21056/11, GJEDNJ, Vendimi i 5 shkurtit 2013, dhe shih, gjithashtu, *Moya Alvarez kundër Spanjës*, Kërkesa Nr. 44677/98, GJEDNJ, Vendimi i 23 nëntorit 1999).
 38. Sa i përket pretendimit të parashtruesve se “si datë për tu llogaritur afati duhet të merret data e Njoftimit të fundit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, pra 2 shtatori 2014”. Gjykata vëren se është fakt që parashtruesit e kanë pranuar Njoftimin e fundit nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në datën e cekur, por sipas këtij njoftimi Kryeprokurori i Shtetit nuk ka ngritur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë përkritazi me çështjen e parashtruesve, me arsyetimin se “nuk kam gjetur bazë ligjore për të ngritur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë”.
 39. Si i tillë, Njoftimi i Kryeprokurorit të Shtetit nuk konsiderohet “vendimi i fundit” lidhur me çështjen e parashtruesve, sepse “vendimi i fundit”, sipas nenit 49 të Ligjit, normalisht do të jetë vendimi i fundit me të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtruesve, që në rastin konkret është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit (Shih, *mutatis mutandis*, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 46477/99, GJEDNJ, Vendim i 14 marsit 2002).
 40. Për arsytet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se “vendimi i fundit” lidhur me çështjen e parashtruesve është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, dhe afati fillon të llogaritet prej datës së pranimit të këtij aktvendimi (Shih, *mutatis mutandis*, *Bayram dhe Yildirim kundër Turqisë*, Kërkesa Nr. 38587/97, GJEDNJ, Vendimi i 29 janarit 2002). Si rrjedhojë, vërehet se parashtruesit e kanë pranuar këtë aktvendim më 26 maj 2014, kurse kërkesën në Gjykatën Kushtetuese e kanë parashtruar më 9 tetor 2014.

41. Bazuar si më lart, rrjedh se kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
42. Nga arsyet e cekura më lart, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri për shkak se është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 9 shtator 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Robert Carolan



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi